



BASHKIA SKRAPAR

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: **Shërbime mirëmbajtje për automjetet për vitin 2025**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **50112200-5**

VLERA E FONDIT LIMIT: **1 546 432** (një milion e pesëqind e dyzetë e gjashtë mijë e katërqind e tridhjetë e dy) lekë **pa TVSH**.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Skrapar ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Për pikën a.- në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 26; për pikën b.-në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 83 “Sigurimi i ofertës”, pika 1 dhe 2, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 30 “Sigurimi i ofertës”, pika 1, 2 dhe 3.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo kërkesë konsiderohet e plotësuar, nëse operatori ekonomik ofertues, është kualifikuar për kriteret e përgjithshme të kualifikimit, të përshkruara në pikën 1, sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, të dorëzuar prej tij, në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, ofertuesi duhet të dorëzojë kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar, për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024, vlera minimale e të cilës të jetë sa 40% e vlerës së llogaritur të fondit limit që prokurohet, e shprehur në 491 800 lekë pa TVSH.

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe pika 1 dhe pika 2, gërma b) dhe pika 3, të nenit 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, pika 1, të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 Për Tatimin mbi të Ardhurat, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Çdo tatimpagues pergatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabel, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.”*

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për detyrimet e vitit 2024.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar apo ka ushtruar aktivitet sipas QKB-së.

Shënim : Operatorët ekonomikë për përmbushjen e kësaj kërkesë duhet të vetëdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST, se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për detyrimet e maturuara për vitin 2024 **(në seksion të veçantë nga taksat dhe detyrimet tatimore në formularin e deklarimit nr.10).**

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 4, si dhe në zbatim të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Shlyerja

e detyrimeve vendore për operatorët ekonomik pjesëmarrës vërteton se ushtrojnë aktivitetin e tyre ekonomik, në përputhje me kuadrin ligjor për taksat dhe tarifat vendore

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme :

Për të provuar përvojën e mëparshme, ofertuesi duhet të dorëzojë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryer gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, vlera e të cilës të jetë sa 20% e vlerës së llogaritur të fondit limit që prokurohet, e shprehur në 245 900 lekë pa TVSH. Për këtë ofertuesi duhet të paraqesë;

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike:
 - Vërtetim për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohet vlera dhe afati i përfundimit të kontratës.
 - Faturë tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat:
 - Faturë tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, pika 2.3.1 gërma a), plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar si dhe nenin 41 pika 3. dhe nenin 55, pika 4, gërma b) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

2.3.2. Operatori ekonomik fitues duhet të garantojë se:

- Ka minimalisht 1 (një) urë riparimi si dhe paisje e vegla pune profesionale për të gjitha llojet e riparimeve.
 - Do të kryejë kontrollin teknik të automjetit në çdo kohë, riparimi dhe shërbimi i automjeteve do të behët menjëherë nga momenti i paraqitjes në servis.
-

- Koha e riparimit do të jetë për riparimet xhenerike jo më shumë se 3 (tre) ditë, për riparimet motorike jo më shumë se 5 (pesë) ditë dhe për riparimet e tjera të sistemeve jo më shumë se 2 (dy) ditë. Përfshirë bëhet vetëm në rastet e defekteve të rënda për të cilat do të negociohet midis palëve kontraktuese.

Shënim: Ky kriter quhet i përmbushur me dorëzimin e deklaratës së garancisë për sa më sipër

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar si dhe nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, AK i kërkon operatorit fitues që të garantojë se është disponibël në çdo moment për kryerjen e shërbimeve, duke mos krijuar vonesa të cilat më pas do të penalizojnë AK. Gjithashtu OE duhet të garantojë se disponon mjetet e nevojshme për kryerjen e shërbimeve, që lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës dhe mbarëvajtjen e saj.

2.3.3. Operatori Ekonomik duhet të disponojnë në pronësi ose me qera një ose më shumë pika servisi brenda territorit të Bashkisë Skrapar. Për të provuar kriterin e mësipërm OE duhet të paraqesë Çertifikata/Vërtetim Pronësie ose kontratë qiraje / vërtetim për vendin e ushtrimit të aktivitetit sipas QKB.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4 dhe 5, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5, shkronja a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë një pikë servisi në pronësi ose qira/ kontratë bashkëpunimi, brenda territorit të Bashkisë Skrapar.

Ky kriter është vendosur për të provuar disponueshmërinë e pikës së servisit nga operatori ekonomik dhe për të garantuar ekzekutimin me sukses të kontratës, nëse operatori shpallet fitues. Përcaktimi i vendndodhjes brenda territorit të Bashkisë Skrapar është vendosur për të bërë të mundur kontrollin teknik dhe kryerjen e shërbimeve të mjeteve të institucionit pa kosto ekstra në karburant, burime njerëzore, apo kosto të tjera prej largësisë.

3. TË PËRGJITHSHME

Pavarësisht sa përcaktohet në pikën 1 “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit”, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në pikën 2, “Kriteret e veçanta të kualifikimit” dhe të paraqitura nga ofertuesi në formularin përmbledhës të deklaratimit, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

SPECIFIKIMET TEKNIKE DHE TERMAT E REFERENCËS

Autoriteti Kontraktor, Bashkia Skrapar, ka ngritur Njësine e Prokurimit për objektin “**Shërbime mirëmbajtje për automjetet për vitin 2025**”. Njësia e Prokurimit pasi mori listën e shërbimeve të nevojshme, kreu studim tregu për hartimin e fondit limit, kjo bazuar në nenin 76, pika 1, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, autoriteti kontraktor duhet të ketë parasysh:

Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet ti referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë:

- a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe
- b) **studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe**
- c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe
- d) Çmime ndërkombëtare, të shpallura publikisht.

Bashkëlidhur dokumenteve gjendet edhe procesverbali për studimin e tregut.

Kërkesa e Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 36 “Specifikimet teknike”, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 neni 2 “Dokumentimi i Procesit”, pika 2 gërma c), dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, lidhur me hartimin e specifikimeve teknike, konsiderohet e plotësuar.

KRITERET E VLERËSIMIT

Njësia e prokurimit, miraton Kriteret e përzgjedhjes së fituesit e cila do të jetë:

Oferta ekonomikisht më e favorshme, **Bazuar në Çmim**

Kontrata do t'i jepet ofertuesit i cili ka ofruar çmimin më të ulët të ofertës, **brenda vlerës minimale dhe maksimale**, siç përcaktohet në VKM-së nr.354 datë 11.05.2016 "Manuali i tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim", për **Klasën “Ndërtesat dhe ndarjet funksionale të tyre”, Grupi Tarifor III**

PËRFUNDIME

Me miratimin e kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit, kriterëve të vlerësimit, si dhe specifikimeve teknike, njësia e Prokurimit miraton Dokumentet Standarte të Tenderit, për procedurën “**Procedurë e hapur e thjeshtuar**” me objekt prokurimi “**Shërbime mirëmbajtje për automjetet për vitin 2025**”. Personi përgjegjës i prokurimit, pjesë e njësisë së prokurimit, të bëjë publikimin e procedurës në Sistemin e prokurimit elektronik, në faqen e APP-së.

NJËSIA E PROKURIMIT

Altin Lamçe

Ernest Ymeri

Florand Osmani
